

**BËHU UP  
BËHU INXHINIER  
STUDIO MEKATRONIKË**

  
**1000 €**

**BURSË E GARANTUAR NGA  
MASHT PËR TË GJITHA VAJZAT**



## HISTORIKU

Bazat e themelimit të studimeve teknike, pra edhe të atyre të makinerisë, u vunë me hapjen e Shkollës së Lartë Teknike në Prishtinë, më 20 tetor 1961. Kjo shkollë kishte tri drejtime: Makinerinë, Elektroteknikën dhe Ndërtimtarinë

## MISIONI


Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike si njësi akademike e Universitetit të Prishtinës "HASAN PRISHTINA" aftëson studentët nga lëmitë e inxhinierisë mekanike, të industrisë, teknologjisë, transportit, etj. për tregun e punës; kontribuon në zhvillimin shkencor, punën kërkimore dhe edukative, bashkëpunimin me ekonominë, me institucione-kompani publike dhe private duke realizuar punë shkencore - hulumtuese, projekte zhvillimore dhe profesionale në fushën e inxhinierisë mekanike dhe industrisë.



**FAKULTETI I  
INXHINIERISË  
MEKANIKE**

**PROGRAMI I STUDIMIT  
BACHELOR**

**MEKATRONIKË**



## VIZIONI

Vizioni i Fakultetit të Inxhinierisë Mekanike është që të jetë i njohur në nivel rajonal, kombëtar dhe ndërkombëtar në ofrimin e arsimit të inxhinierisë mekanike, duke çuar në inxhinierë të kualifikuar, të cilët janë inovativë, kontribues në profesionin e tyre dhe të suksesshëm në studimet e avancuara, duke promovuar programe akademike që rrisin maksimalisht kontributet e UP-së në zhvillimin ekonomik të Kosovës.

Inxhinierët e mirë përgatitur të Mekatronikë gjejnë zgjidhje në fushën e inxhinierisë:

- Projektimi dhe zhvillimi i sistemeve elektro-mekanike.
- Programimin e robotëve industrial.
- Projektimi i sistemeve të kontrollit kompjuterik për pajisjet e prodhimit.
- Zhvillojnë logjikën e programimit për prodhimin e pajisjeve.
- Automatizimin e proceseve industriale përmes PLC.
- Monitorimin e proceseve industriale përmes HMI & SCADA.
- Dizajnimin e sistemeve mekatronike.
- Identifikoni zonat e dobëta në linjën e prodhimit ose produktet e gatshme.
- Analizojnë qëndrueshmërinë dhe përfitimet e performances së pajisjeve të reja mekatronike.
- Rekomandojnë modifikime kur është e nevojshme në linjat prodhuese të sistemeve mekatronike.

## KONTAKTI

+383(0)38 552 126

Rruga Kodra e Diellit, p.n. 10000, Prishtinë  
fim@uni-pr.edu  
<https://fim.uni-pr.edu>

Mekatronika është bërë çelës për shumë prodhime dhe shërbime në industri. Sistemet moderne sot e kanë arritur nivelin e përsosshmërisë, nivel të cilin ka qenë vështirë ta imagjinojmë me përdorimin e teknologjive tradicionale

Mekatronika integron fushat klasike të inxhinierisë mekanike, elektrike, kompjuterike dhe teknologjinë informative për të realizuar parimet bazë të metodologjisë bashkëkohore të sistemeve Mekatronike. Kurrikula për studimet baçelor në fushën e Mekatronikës mbështetë integrimin sinergjetik të inxhinierisë mekanike precize, dirigjimin elektronik dhe sistemet mekatronike, gjithnjë duke menduar në disajnimin, realizimin, operimin dhe mirëmbajtjen e riparimin e sistemeve të linjave të automatizuara dhe shërbimeve "inteligjente"

Tregu i punës në Mekatronikë përfshin të gjithë sektorët e industrisë, si dhe kompanitë e angazhuara në:

- Automatizimin Inteligent (konceptet moderne të programimit),
- Metodrat dhe sistemet Mekatronike (Mekatronika e përgjithshme, robotika industriale), robotika e avancuar (robotët e lëvizshëm dhe shërbyes).
- Prodhimin e sistemeve të ndryshme Mekatronikë.
- Prodhimtaria Inteligjente etj.

